

**AIDA DUKA**

**ASPEKTE TË VEPRIMTARISË SË KOMUNITETIT  
MYSLIMAN GJATË VITEVE TË MONARKISË  
NË SHTYPIN E KOHËS**

**1. Marrëdhëniet midis komunitetit mysliman  
dhe shtetit shqiptar gjatë periudhës së konsolidimit të tij**

Zhvillimet historike nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë kanë krijuar një mozaik të ndërlikuar fetar. Ky fakt për çdo popull tjetër do të kishte qenë një fatkeqësi e vërtetë, pasi mund të ndikonte në përçarjen kombëtare. Por ndryshe ndodhi në vendin tonë, në të cilin përgjithësisht, u evidentua ndjenja e tolerancës fetare. Toleranca fetare u përfaq në kapërcimin e momenteve të vështira, në të cilat u gjend vendi ynë gjatë historisë së tij. Ajo luajti një rol pozitiv gjatë përballjeve të popullit tonë me ndërhyrjet e vazhdueshme të fqinjëve, të cilët kërkonin të mbillnin përçarje dhe armiqësi midis shqiptarëve. Kështu mund të themi se toleranca fetare, duke i lënë një rreze të vogël veprimi këtyre ndërhyrjeve, u bë pjesë përbërëse e platformës kombëtare, e cila synonte ruajtjen e ekzistencës së kombit dhe shpalljen e pavarësisë së vendit.

Shqiptari në çdo rast e quante veten shqiptar. Me këtë pohim nuk nënkuptohej mohimi i fesë, por vlerësim i ndjenjës kombëtare, të cilës i jepej një vlerë e veçantë në raportin midis fesë dhe kombit. Mbivënia e ndjenjës kombëtare ndaj asaj fetare bënte që ekzistenca e disa besimeve në vend të mos bëhej shkak i përçarjes midis elementëve të ndryshëm të këtyre besimeve. Mirëkuptimi që kishin këta elementë për njëri-tjetrin vërtetohej edhe me respektin që myslimanët kishin për shenjtët e krishterë, të cilëve iu festonin edhe ditët e kushtuara<sup>1</sup>.

Kur Shqipëria u anëtarësua në Lidhjen e Kombeve, në dhjetor 1920, delegati indian evidentoi faktin e çuditshëm, por edhe të admirueshëm, që në një vend kaq të vogël jetonin në harmoni dy fetë më të mëdha të njerëzimit. Të huajt janë munduar që të krijojnë dasi

<sup>1</sup> “Zani i Naltë”, tetor 1931, nr.2, f.57.

ndërmjet shqiptarëve të besimeve të ndryshme, por një pjesë e tyre kanë evidentuar vlerën unike të tolerancës fetare në vendin tonë. Ata pranuan se në çdo formë, dasitë fetare nuk kanë pasur peshë në Shqipëri.

Ideja kombëtare mbrohej me xhelozë nga shqiptarët, të cilët shpejt e kuptuan se forcimi i ndjenjës kombëtare ishte veprimi i vetëm që do të garantonte mbijetesën dhe do të siguronte pavarësinë.

Megjithatë toleranca fetare nuk ishte një ndjenjë kalimtare, e cila lidhej thjesht me rrezikun e kërcënimit dhe të zhdukjes si komb. Ajo nuk u venit me kapërcimin e këtij rreziku, pasi kjo ndjenjë ishte e lidhur me një mendësi të brendshme, të kultivuar gjatë shekujve. Të huajt skeptikë për aftësitë qeverisëse të shqiptarëve, mendonin se në paqe kjo ndjenjë do të shuhej dhe me kapërcimin e problemeve që lidheshin me politikën e jashtme, në vend do të fillonin grindjet fetare. Mirëpo ky parashikim tendencioz nuk u vërtetua, pasi toleranca fetare përgjithësisht mbeti një vlerë e spikatur e shqiptarëve.

Toleranca fetare ishte një element tjetër që u bë pjesë e procesit të vështirë të konsolidimit të shtetit shqiptar. Në momente të caktuara kjo ndjenjë luajti një rol pozitiv në këtë proces të ndërlikuar duke u bërë baza e konsolidimit të shtetit dhe emancipimit shoqëror të vendit. Duke e vlerësuar në këtë mënyrë tolerancën fetare, qeveria e Sulejman Delvinës, e krijuar në Kongresin e Lushnjës, e ktheu atë në devizën e vet për të shmangur problemet. Kështu, kjo qeveri u përpoq ta institucionalizojë tolerancën fetare duke e kthyer në një element të rëndësishëm të nacionalizmit shqiptar. Jo pa qëllim në përbërjen e Këshillit të Lartë të dalë nga Kongresi i Lushnjës kishte përfaqësues të katër besimeve fetare në vend. Abdi Toptani muhamedan, Mihal Turtulli ortodoks, Aqif Pashë Elbasani bektashi, Imzot Bumçi katolik.

Të njëjtën politikë balancuese ndoqi edhe Ahmet Zogu në qeverisjen e vendit gjatë gjithë karrierës së tij politike. Duke vendosur një balancë në qeverisje ai siguronte qetësinë në vend dhe harmoninë midis komuniteteve fetare duke shmangur çdo lloj xhelozie midis tyre. Mjafton të përmendim se Presidenti i Parlamentit në vend ishte një ortodoks Koço Kota, i cili zëvendësohet me një tjetër ortodoks Pandeli Evangjeli. Ministër i Brendshëm ishte një mysliman, Musa Juka, ashtu si edhe ministri i Punëve të Jashtme Eqerem Libohova<sup>2</sup>.

---

<sup>2</sup> A. Ryan, *The last of the dragomans*, Londër, 1951, f.321.

Dukej se qeveria i kishte marrë të gjitha masat për sigurimin e harmonisë fetare midis tre komuniteteve fetare më të mëdha në vend. Për këtë ajo kujdesej që në krye të këtyre komuniteteve të viheshin elementë reformatorë e mbi të gjitha, atdhetarë të mirë. Në lidhje me këtë, domethënës ishte fakti se në varrimin e të ndjerit, patriotit të madh, reformatorit të komunitetit mysliman, Vehbi Dibrës mori pjesë edhe kryepeshkopi i KOASH Visarion Xhuvani. Në fjalimin e tij, ky i fundit, vlerësoi rolin pozitiv që kishte luajtur Vehbi Dibra në afrimin e dy komuniteteve. Me të drejtë Visarion Xhuvani u shpreh se për të parën herë, ndoshta në gjithë botën, një kryepriift kristian ortodoks merrte pjesë në varrimin e një hoxhe mysliman<sup>3</sup>.

Ky lloj qëndrimi i shërbente platformës kombëtare, por edhe nderonte këto figura udhëheqëse të jetës shpirtërore të popullit tonë. Duke dhënë shembullin të parët ata e quanin njëri-tjetrin vëllezër. Ndërsa më parë klerikët edhe kishin luajtur në ndonjë rast një rol përcarës nën ndikimin e propagandave të huaja, tani ata përveç misionit të tyre fetar përmbushnin edhe misionin e tyre patriotik në të mirë të bashkimit të kombit.

Megjithëse kërcënimi i huaj ishte kapërcyer, veprimtaria e komuniteteve fetare ishte nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të qeverisë, e cila nuk i linte asgjë të papriturës. Toleranca fetare duhej ushqyer vazhdimisht, dhe sidomos duhej përshtatur me kushtet e reja në të cilat ndodhej vendi. Ajo mund të errësohej nga fanatizma ose lufta politike midis grupeve të ndryshme në vend. Kështu cenohej bashkëpunimi midis elementëve të besimeve të ndryshme dhe gjendja e brendshme në vend. Kjo gjë kishte ndodhur gjatë viteve 1920-1924, që ishin vitet e para të jetës së pavarur të shtetit shqiptar pas Luftës së Parë Botërore. Ishin bërë propaganda të rrezikshme, të cilat kishin përdorur dasitë fetare për të pasur përfitime politike.

Deputetët ortodoksë të Korçës, në vitin 1922, botuan në gazetën “Omonia” të Timo Dilos një memorandum, i cili propozonte ndarjen e vendit në kantone sipas besimeve fetare<sup>4</sup>. Të njëjtin propozim bënë edhe katolikët duke kërkuar krijimin e një shteti katolik në Shqipërinë e Veriut. Të dyja këto propozime sipas autorëve lidheshin me faktin se myslimanët ishin shumë të prapambetur dhe kështu pengonin zhvillimin e vendit. Deklarata të tilla mund të sillnin pasoja të rrezikshme për

<sup>3</sup> “Zani i Naltë”, prill 1937, nr.4, f.111.

<sup>4</sup> “Shqipëria e re”, 4 qershor 1922, f.1.

integritetin e vendit, ndaj për këtë arsye edhe veprimtaria e komuniteteve fetare në vend, sidomos raportet midis këtyre komuniteteve ishin në qendër të vëmendjes së qeverisjes së vendit.

Në vitin 1935 midis dy revistave “Rilindja” e Komunitetit Ortodoks dhe “Zani i Naltë” i Komunitetit Mysliman pati replika të ashpra. Në qendër të tyre ishin artikujt akuzues të redaktorit të “Rilindjes”, i cili e quante fenë myslimane dhuratë të armikut, duke shtuar se dhuratat e armikut kishin helm brenda<sup>5</sup>. Këto deklarata të ashpra ishin rrjedhojë e disa artikujve të “Zanit të Naltë” në lidhje me konvertimet e disa të krishterëve në myslimanë. Replikat midis këtyre dy gazetave do të bëheshin më të ashpra në qoftë se qeveria nuk do të merrte masa të menjëhershme, duke mbyllur “Rilindjen” pasi ajo nuk i shërbente interesave kombëtare<sup>6</sup>.

Pikërisht, për të mos e lënë situatën evazive dhe për të mos u përsëritur këto ngjarje të papëlqyeshme, qeveria, qysh më parë, ishte kujdesur për futjen e frymës kombëtare në predikimet fetare, për reformimin e brendshëm dhe për vendosjen brenda një kuadri ligjor të përcaktuar qartë të besimeve fetare në vend. Ndër masat e para të shtetit të ri shqiptar në këtë drejtim përmendim vendimin e Këshillit të Ministrave të 5 majit të vitit 1913 për rishikimin e padive fetare nga kadinjtë, ndërsa Këshilli i Ministrave më 1 dhjetor 1920, vendosi që kadilerët dhe mitropolitët të mos merrnin pjesë në Këshillat Administrative<sup>7</sup>.

Në vazhden e një politike reformuese të ndjekur nga qeveria e asaj kohe ndaj komuniteteve fetare, u përkrahën prej saj edhe kongreset e para fetare. Këto kongrese i hapën rrugën reformimit të brendshëm të komuniteteve fetare duke përcaktuar rregulloret dhe statutet e tyre.

Pas fillimit të këtij procesi, të reformimit të brendshëm të besimeve fetare, filloi puna për hartimin e një ligji, i cili do të përcaktonte statusin e komuniteteve fetare në raport me shtetin në bazë të kushteve të reja në të cilat ndodhej vendi. Në përpjekje për të përmbushur këtë detyrë u miratua dekretligji për komunitetet fetare i vitit 1923. Ky ligj përbënte një arritje tjetër të qeverisë në përpjekjet e saj për krijimin e një shteti ligjor që do të drejtonte vendin në rrugën e përparimit. Shteti, me politikën e tij ndaj komuniteteve fetare, arriti të fashitë rolin negativ të fesë në jetën e

<sup>5</sup> Edwin Jacques, *Shqiptarët*, Tiranë, 1995, f.439.

<sup>6</sup> *Po aty*, f.440.

<sup>7</sup> Kahreman Ulqini, *Faktorë kulturorë dhe fetarë*, Shkodër, 1999, f.73.

vendit<sup>8</sup>. Me këtë qëndrim shteti nuk kishte për qëllim t'i dominonte apo diktonte besimet fetare, por thjesht të përcaktonte statusin e tyre ligjor në një vend laik dhe demokratik. Statusi i vjetër që këto besime kishin pasur nuk i përshtatej nevojave dhe kushteve të kohës të krijuara qysh me fitoren e pavarësisë së vendit. Shumë kompetenca të klerit në fushën administrative dhe civile tashmë i kishin kaluar qeverisë, siç ishte edhe e drejtë të ndodhte.

Në vazhden e këtyre ndryshimeve erdhi natyrshëm, si një domosdoshmëri e kohës, ligji për organizimin e komuniteteve fetare. Në këtë ligj, në radhë të parë, garantohej liria e ndërgjegjes dhe respektimi i të gjitha besimeve fetare në vend. (Neni 93 i statutit bazuar në Nenin 1-2 të deklaratës së votuar nga parlamenti në tetor 1921)<sup>9</sup>. Gjithashtu garantohej liria e organizimit të çdo sektit fetar dhe mbajtja e lidhjeve spirituale dhe dogmatike me qendrat e mëdha të besimeve fetare në vend. Një vend të rëndësishëm zinte përcaktimi i cilësive që duhet të kishte kleriku si përfaqësues i besimit fetar, por edhe si shqiptar. Në këtë drejtim u përcaktua qartë se klerikët duhet të ishin shqiptarë prej race dhe të kishin nënshpirtësi shqiptare. Përveç se klerikë të përgatitur, ata duhet të ishin atdhetarë të ndershëm dhe të predikonin fenë në gjuhën e kombit. Një kusht tjetër që vlerësonte veprimtarinë e tyre patriotike ishte se ata nuk duhet të kishin luftuar çështjen shqiptare që nga 28 nëntori i vitit 1912 e këtej<sup>10</sup>. Ky ligj i jepte komuniteteve fetare të drejtën e administrimit të pasurive të tyre dhe të drejtën për të marrë masa disiplinore ndaj klerit.

Miratimi i këtij ligji ishte një hap përpara në krijimin e legjislacionit bashkëkohor në vend, por ligji ishte përfunduar plotësisht. Ai u perfeksionua më tej në vitin 1929 pas kongreseve fetare që u mbajtën në këtë kohë. Këto kongrese vijuan punën e nisur në vitet 20 për reformimin e komuniteteve fetare në vend. Në të njëjtën mënyrë vijoi të evoluonte edhe ligji për komunitetet fetare.

Në dekretligjin e vitit 1929 konfirmoheshin vendimet e ligjit të vitit 1923 ndaj besimeve fetare dhe klerikëve të tyre. Në të thuhej shprehimisht se komunitetet fetare kishin për qëllim ushtrimin e organizimit të besimeve të tyre sipas dispozitave të ligjit për komunitetet fetare dhe të ligjeve të tjera të shtetit. Sektet fetare kishin të drejtën e

<sup>8</sup> Dilaver Sadikaj, *Veçoritë sociale gjatë shek.XX dhe ndikimi i tyre në stabilitetin e jetës politike të vendit (1912-1920)*, "Studime historike", Tiranë, 2001, nr.3-4, f.186.

<sup>9</sup> "Fletorja zyrtare", 27 qershor 1923, f.2.

<sup>10</sup> Po aty.

organizimit dhe të zgjedhjes së krerëve të tyre në bazë të rregulloreve përkatëse, përveç sekteve me rëndësi, krerët e të cilëve do të zgjidheshin prej komuniteteve fetare por edhe do të miratoheshin prej qeverisë me dekret mbretëror, ashtu siç veprohej me zgjedhjen e krerëve të besimeve fetare në vend<sup>11</sup>. Përballë shtetit këto komunitete ishin persona moralë gjersa të konformoheshin dhe të organizoheshin në bazë të ligjeve të tij. Dukej qartë se qëndrimi i shtetit në lidhje me reformimin e besimeve fetare nuk kishte ndryshuar. Madje, ai ishte bërë më i vendosur me forcimin e pozitave të tij dhe marrjes nën kontroll të jetës së brendshme të vendit.

Në vitet 1920-1925 shteti kishte qenë i detyruar të mbante një qëndrim më të moderuar ndaj besimeve fetare, për të mos nxitur revolta ndër katolikët e Shqipërisë së Veriut dhe për të mos humbur përkrahjen e myslimanëve. Ky fakt vihej re në një njoftim të Ahmet Zogut, i vitit 1925, në të cilin ai i udhëzonte prefekturat e Dibrës dhe të Elbasanit që të mos kundërshtonin vendimet që merreshin në bazë të sherihatit dhe të ligjeve kanonike kishtarë<sup>12</sup>. Përveç arsyeve që kishin të bënin me ruajtjen e stabilitetit në vend, këto ligje i shërbenin shtetit, ndonëse përkohësisht, për të mbushur vakuumin ligjor që ekzistonte në vend.

Marrëdhëniet e moderuara të shtetit në vitet e konsolidimit të tij ndaj besimeve fetare në përgjithësi dhe komunitetit mysliman në veçanti, vërehen edhe në korrespondencën e mbajtur midis tyre. Në një artikull të revistës “Zani i Naltë” botohej një ankesë e klerit mysliman bërë qeverisë së Nolit për lënien pas dore të mësimin të fesë në shkolla, si dhe për shpërpjesëtimin e fondeve në krahina të ndryshme<sup>13</sup>. Në shkresën që Ministria e Arsimit i dërgoi Këshillit të Sherihatit për këtë problem, udhëzonte që mësimi i fesë duhej të bëhej në përshtatje me nevojat shtetërore dhe njerëzore në mënyrë që shkolla t’i mësonte fëmijëve se ndryshimi në fe nuk duhet t’i ndalonte shqiptarët të ishin atdhetarë të mirë dhe nënshtetas të ndershëm të gatshëm për t’u bërë fli për atdheun<sup>14</sup>. Por dhe pas marrjes së shkresës së Ministrisë së Arsimit, ankesat e këtij komuniteti vijuan. Ata ishin dakord me futjen e frymës patriotike në mësimet e fesë, por shprehnin pakënaqësi për faktin se mësimin të fesë nuk i jepej rëndësia e duhur, ndërsa mësuesit e fesë nuk paguheshin nga

<sup>11</sup> “Gazeta e Korçës”, 24 dhjetor 1929, f.1.

<sup>12</sup> Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri në vitet 1912-1939*, Tiranë, 2002, f.149.

<sup>13</sup> “Zani i Naltë”, mars 1925, nr.1, f.409.

<sup>14</sup> Po aty, f.411.

shteti si mësuesit e tjerë. Një ankesë tjetër i dërgohej Këshillit Kushtetues nga Kryesia e Lartë e Këshillit të Sherihatit, në të cilën kërkohej që çështjet të cilat i përkisnin Sherihatit, të lireshin në kompetencën e tij. Gjithashtu u kërkuar një subvencion nga qeveria ose kthimi i çifligjeve dhe vakëfeve fetare, të cilat ndodheshin në duart e qeverisë<sup>15</sup>.

Raporti midis qeverisë dhe komuniteteve fetare vijoi të evoluonte më tej në vitin 1929, kur qeveria miratoi ligjin e ri të komuniteteve fetare në vend. Me këtë ligj, raportet midis qeverisë dhe komunitetit mysliman ndryshuan në favor të qeverisë. Të dhëna bindëse për këtë fakt na japin edhe diskutimet në parlament në lidhje me këtë dekretligj. Në këto diskutime, përfaqësuesit e qeverisë u shprehën se nuk do të praninin asnjë kundërshtim. Ata thjesht kërkuar pranimin e ligjit në parim, aq më tepër, që nuk ishin përcaktuar detajet e tij. Kompetencat për rregullimet që do t'i bëheshin këtij ligji ishin lënë në duart e një komisioni të ngarkuar me këtë punë<sup>16</sup>. Në këtë mënyrë iu pre rruga çdo diskutimi ndaj vendimeve të marra prej qeverisë.

Por kontrollin e plotë në jetën administrative dhe shoqërore të shtetasve të vet, qeveria e vendosi me hyrjen në fuqi të kodit civil, i cili zëvendësoi statutin fetar, të bazuar në juridiksionin e kishave kristiane në vend dhe në ligjin islamik të Sherihatit. Kështu qeveria me anën e ligjeve të shtetit vendosi brenda një kuadri ligjor aspektet e jetës shoqërore dhe familjare të shtetasve. Këto ligje tashmë do të zbatoheshin nga nëpunës të shtetit, të cilët zëvendësuan gjyqtarët islamikë<sup>17</sup>.

Ky ligj e afronte vendin tonë një hap më pranë botës së qytetëruar perëndimore.

Qysh në kohën e Perandorisë Osmane, si dhe gjatë konsolidimit të shtetit shqiptar, (nga Shpallja e Pavarësisë deri në vitin 1924), institucionet fetare me normat e tyre të bazuara te Sherihati dhe juridiksioni i kishës ishin kthyer në organizata që administronin jetën sociale të besimtarëve, duke marrë mbi vete detyra dhe përgjegjësi që në fakt i takonin shtetit<sup>18</sup>. Këtë ndikim të madh të tyre asnjë qeveri nuk mund ta toleronte, aq më tepër në një vend ku ekzistonte një mozaik i vërtetë fetar. Në qoftë se qeveria nuk do të merrte masa në këtë drejtim

<sup>15</sup> Po aty, 1924, nr.4, f.125.

<sup>16</sup> "Gazeta e Korçës", 30 nëntor 1929, f.2.

<sup>17</sup> Roberto Moroco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri (1920-1944)*, Tiranë, 1994, f.30.

<sup>18</sup> F. Musaj, *vep. e përm.*, f.23.

dhe do të ruante *status quo*-në atëherë do të krijohet një shtet brenda shtetit në aspektin institucional, ndërsa në aspektin shoqëror vendi do të mbetet në një nivel të ulët zhvillimi, që do ta largonte nga qytetërimi modern. Për këtë arsye, politika e laicizmit që ndoqi Zogu synonte të pakësonte rolin e feve në jetën e vendit dhe sidomos në punët e shtetit<sup>19</sup>.

Kjo ishte një praktikë e njohur edhe në vendet e tjera të Ballkanit. Greqia, e cila e kritikonte aq shumë qeverinë tonë për ndërhyrje në çështjet fetare dhe për shkelje të lirisë së besimit, sidomos të ortodoksëve, në përpjekje për të konsoliduar shtetin e saj kishte ndjekur të njëjtën politikë. Në Greqi, madje qeveria kishte vënë nën kontroll Sinodin e Shenjtë të Kishës Ortodokse Greke, anëtarët e të cilit zgjidheshin nga qeveria dhe mbreti. Asnjë vendim i Sinodit nuk aprovohej për t'u publikuar pa lejen e qeverisë<sup>20</sup>.

Një politikë të ngjashme ndoqi Ataturku për reformimin e vendit të tij dhe krijimin e Turqisë moderne. Reformat e nisura prej tij, si rrëzimi i Kalifatit, ligji i ndalimit të mbajtjes së mbulesës fetare nga klerikët jashtë objekteve fetare<sup>21</sup> u cilësuan nga bota perëndimore si një hap drejt përparimit dhe jo si një shkelje e të drejtave të komuniteteve fetare.

Në të njëjtën linjë eci reformimi fetar edhe në vendin tonë. Ahmet Zogu, me anë të ligjeve garantoj ekzistencën e komuniteteve fetare. Në Statutin e Republikës dhe të Monarkisë cilësohej se Shqipëria nuk kishte fe zyrtare, por të gjitha fetë dhe besimet ishin të respektuara dhe garantohej me ligj liria e predikimit<sup>22</sup>. Ndërsa në kodin penal kishte një nen të veçantë, i cili kishte të bënte me deliktet kundër fesë dhe lirisë së ndërgjegjes. Ky ligj dënonte ata persona, të cilët poshtëronin ndonjë nga fetë e nderuara të shtetit<sup>23</sup>. Dënoheshin të gjithë ata që ndalonin ose turbullonin funksionimin e fesë dhe të ceremonive fetare, ata që ofendonin klerikët ose përdhosnin objektet e shenjta fetare dhe varrezat. Dënimet në këto raste shkonin nga gjoja të rënda dhe deri në burgim (3 muaj – 1 vit). Duke përcaktuar qartë pozicionin e komuniteteve fetare para ligjit shmangej çdo mundësi për lindjen e mosmarrëveshjeve midis tyre, ose ndikimin e tyre në çështje politike duke cenuar stabilitetin në

<sup>19</sup> R.M. dela Roka, *vep e përm.*, f.130.

<sup>20</sup> Ch.A. Frazee, *The orthodox church and the independent Greece (1821-1852)*, Cambridge University, 1969, f.113.

<sup>21</sup> "Gazeta e Korçës", 5 dhjetor 1934, f.1.

<sup>22</sup> A. Gianini, *L'Albania dall'indipendenza all'unione con l'Italia (1913-1939)*, Varese, 1940, f.279.

<sup>23</sup> "Fletorja zyrtare", 1 janar 1928, f.19.

vend. Në statut thuhej shprehimisht se feja nuk mund të përbënte asnjë pengim juridik, fetë nuk mund të përdoshin kurrë për qëllime politike<sup>24</sup>.

Me përmbyshjen e kuadrit ligjor në lidhje me komunitetet fetare u shënua një arritje tjetër në historinë e shtetit shqiptar. Përfshirja e besimeve fetare në platformën kombëtare ishte një pikë e rëndësishme e programit politik të Ahmet Zogut. Ai u kujdes në mënyrë të veçantë që të riorganizonte bashkësinë myslimane, dobësia e së cilës rrezikonte të shtynte disa eksponentë të saj që të kërkonin modele jashtë vendit, në botën e gjerë të islamit<sup>25</sup>. Për të arritur këtë qëllim ai përdori metoda të ndryshme, në varësi të situatës së brendshme dhe të jashtme, në të cilën ndodhej vendi. Në këtë drejtim ai u shfaq një partizan i denjë i politikës: qëllimi justifikon mjetin. Por mund të themi me bindje se rezultati i kësaj politike, jo gjithnjë korrekte, ishte radhitja e vendit tonë në krahun e vendeve të përparuara në lidhje me zbatimin e një legjislacioni modern. Përsa i përket islamit shqiptar ai po i shfaqej Evropës me një mendësi moderne, duke i dhënë atij një status të veçantë në një qytetërim të krishterë.

Emancipimi i shoqërisë sonë dhe futja e një mendësie reformatore në organizimin e brendshëm të komuniteteve fetare përbënte një tjetër sukses për vendin tonë, që padyshim ia rriste prestigjin në qarqet ndërkombëtare. Edhe opinioni publik në vend i pranoi reformat e kodit civil, si: martesën civile, ligjërimin e divorcit, të drejtën e trashëgimisë, heqjen e festes, ndalimin e temenasë dhe zbulimin e fytyrës dhe duarve të gruas myslimane. Këto reforma dëshiroheshin sidomos nga elita, e cila kërkonte ta çonte vendin drejt përparimit, por pa cenuar bazën e fesë dhe identitetin kombëtar<sup>26</sup>. Në këtë drejtim ajo luajti një rol vendimtar pasi u bë përcjellëse e këtyre reformave në popull.

Në rrugën e gjatë të reformimit nuk ishte vetëm qeveria dhe intelektualët që u përballën me të vjetrën, por edhe vetë klerikët e lartë të komuniteteve fetare, sidomos atij mysliman. Në programin e tyre ato kishin përcaktuar një politikë reformimi të brendshme, e cila i shërbeu si pikë referimi qeverisë. Më pas, komunitetet fetare mbajtën një qëndrim pozitiv ndaj programit të reformave të hartuara nga qeveria, madje u vunë në krye të tyre. Pjesë thelbësore e kësaj lëvizjeje ishte komuniteti mysliman, i cili nuk u mbyll në vetvete por duke parë në mënyrë

<sup>24</sup> A. Gianini, *vep. e për.*, f.279.

<sup>25</sup> R.M. dela Roka, *vep. e për.*, f.130.

<sup>26</sup> K. Ulqini, *vep. e për.*, f.76.

objektive kritikate që i bëheshin, u përpoq që të nxirrte mësim të vlefshme në të mirë të kombit. Ai u bë një aktor i rëndësishëm në emancipimin e jetës shoqërore të vendit.

## 2. Lëvizjet reformuese brenda komunitetit mysliman

Komuniteti mysliman shqiptar dha një ndihmesë të madhe në emancipimin shoqëror të vendit me anë të vetëreformimit të tij, ashtu siç kishte dhënë një kontribut të vyer në arritjen e fitores së pavarësisë së vendit. Figura të rëndësishme të islamit u vunë në krye të Lëvizjes Kombëtare. Ndër to mund të përmendim Hafiz Maliq Tanushën, i cili ishte ndër të parët që dha kontributin e vet moral dhe material për çështjen e idealit kombëtar<sup>27</sup>. Një tjetër atdhetar mysliman ishte Haxhi Vildani, i cili u vu në krye të lëvizjes për gjuhën shqipe, madje u shpreh për përdorimin e alfabetit latin, i cili nuk sillte asnjë pengim nga pikëpamja fetare, por lehtësonte mësimin e gjuhës<sup>28</sup>. Ky qëndrim ishte një provë tjetër e faktit se në radhët e klerit mysliman kishte punëtorë të palodhur të idesë kombëtare.

Por figura më e spikatur e këtij komuniteti mbetet Vehbi Dibra (Agolli), i cili vuri themelet e pavarësisë së islamit në Shqipëri. Ai dha një kontribut të vyer në konsolidimin e ndjenjës fetare në popullsinë myslimane shqiptare. Fryma që futi Vehbi Dibra në këtë drejtim, ishte që kjo ndjenjë fetare të mos lëkundej asnjëherë nga diversiteti i feve, duke bërë kështu që, në kushtet e këtij diversiteti të realizohej ai unitet i lavdërueshëm i besimeve të ndryshme në vendin tonë<sup>29</sup>. Por për të ruajtur këtë unitet i duhej dhënë fund ndërhyrjeve të huaja në çështjet e brendshme të shtetit shqiptar, sidomos në ato fetare. Vehbi Dibra, në funksion të këtij arsytimi, ishte i pari që kërkoi shpërndarjen e xhamisë shqiptare nga kalifati, si kusht thelbësor për reformimin e brendshëm të islamit shqiptar.

Fillesat e veta ky reformim i pati qysh në vitin 1912 kur qeveria e Ismail Qemalit e caktoi Vehbi Dibrën kryemyfti të Shqipërisë pa e pyetur Stambollin<sup>30</sup>, mbështetur në arsytimin se duke qenë se vendi ynë kishte fituar pavarësinë politike, nuk kishte pse të pranonte varësi fetare nga asnjë fuqi e huaj, qoftë kjo dhe me karakter fetar, si Kalifati. I palëkundur

<sup>27</sup> “Zani i Naltë”, nëntor 1937, nr.11, f.336.

<sup>28</sup> Po aty. f.338.

<sup>29</sup> Qazim Xhelili, *Vehbi Dibra, personalitet dhe veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare*, Tiranë, 1998, f.192.

<sup>30</sup> K. Ulqini, *vep. e përm.*, f.73.

në qëndrimin e tij, Vehbi Dibra insistonte në futjen e gjuhës shqipe në xhami dhe në gjyqet e sherihatit duke mos pranuar asnjë shkresë të paraqitur në gjuhën turke<sup>31</sup>. Por platformën e tij të plotë kombëtare për mëvetësimin dhe reformimin e xhamisë shqiptare, ai e shfaqti në Kongresin e Parë Mysliman të mbajtur në shkurt 1923, në Tiranë.

Ky kongres përbënte një moment kulmor në historinë reformuese të komunitetit mysliman. Ai u mbledh mbi bazën e kërkesave të parashtruara nga qytete të ndryshme të vendit, të cilat Gjyqi i Lartë i Sherihatit ia paraqiti autoriteteve kompetente shtetërore duke i kërkuar lejen për mbajtjen e një kongresi mysliman<sup>32</sup>. Pasi u dha leja nga Ahmet Zogu, filloi përzgjedhja e delegatëve, të cilët duhet të dinin të lexonin dhe të shkruanin shqip. Qëllimi kryesor i këtij kongresi ishte shpallja e xhamisë së pavarur shqiptare, e cila i kishte rrënjët tek një kërkesë e bërë nga myslimanët qysh në vitin 1921, nga një aleancë kombëtare myslimane<sup>33</sup>.

Në këtë kongres, për herë të parë u krijuan organet e pavarura të xhamisë shqiptare, të cilat përcaktuan shkëputjen *de jure* të saj nga Kalifati, pasi kjo shkëputje *de facto* kishte ndodhur me fitoren e pavarësisë kombëtare, duke respektuar parimin xhami e lirë në shtet të lirë, të njëjtin parim që kishin përdorur ortodoksët për kishën e tyre në kongresin e tyre të vitit 1922.

Një arritje e madhe për kongresin ishte miratimi i statutit të xhamisë, i cili shquhej për një frymë liberale dhe kombëtare. Në nenin II të statutit thuhej se xhamia shqiptare duhet të siguronte bashkim midis myslimanëve dhe të shfaqte shpirtin liberal të myslimanizmit duke bërë reforma pa i prekur themelet fetare dhe kombëtare<sup>34</sup>.

Vendimet më të rëndësishme u morën në lidhje me cilësitë e klerikëve. Ata duhet të ishin shqiptarë prej race dhe nënshtetësie, ndërsa gjuha e predikimit duhej të bëhej gjuha shqipe. Ajo duhej të përdorej në hytbet e së premtes në të gjitha xhamitë e qytetit<sup>35</sup>. Këto veprime u pritën me gëzim nga opinioni publik, i cili përgëzoi këtë nismë të komunitetit mysliman shqiptar. Këto lloj reformash ishin një domosdoshmëri e kohës për një vend në qendër të Evropës, i cili nuk mund të qëndronte indiferent para ndryshimeve sociale që po ndodhnin.

<sup>31</sup> Q. Xhelili, *vep. e përm.*, f.209.

<sup>32</sup> "Rilindja", 21 janar 1998, f.12.

<sup>33</sup> R.M. dela Roka, *vep. e përm.*, f.28.

<sup>34</sup> "Rilindja", 21 janar 1998, f.12.

<sup>35</sup> Po aty.

Duke iu përgjigjur këtyre kërkesave në këto vite komuniteti mysliman bëri hapa gjigantë, u diskutuan çështje të cilat deri para pak kohësh kishin qenë tabu. Njëra prej tyre ishte përpjekja për reformimin e statusit të gruas myslimane duke kërkuar miratimin e ligjit për heqjen e perçes më 9 prill 1923 dhe marrjen pjesë të gruas në jetën shoqërore të vendit<sup>36</sup>. Një tjetër çështje që e shqetësonte komunitetin ishte përgatitja e klerit dhe përkthimi i librave të shenjta në gjuhën shqipe. Pa zgjidhur këtë problem, predikimi në gjuhën shqipe mbetej i parealizueshëm. Me këtë mision të shenjtë u morën intelektualë të shquar të kohës, si: Ferid Vokopola, Hafiz Ibrahim Dalliu etj. Në radhët e këtij kleri u dalluan teoricienë në fushën e ideologjisë islame, si: Salih Vuçiterna dhe Haki Sharofi, i cili ishte drejtues i revistes islamike “Zani i Naltë”, orientalistë të përgatitur, si Tahir Dizdari<sup>37</sup>. Duke predikuar në gjuhën amtare klerikët afruan popullin më tepër me ndjenjën fetare, por gjithashtu forcuan tolerancën midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme. Nga ana tjetër, në përgjithësi, kjo shërbeu si një armë e fuqishme për t’i prerë rrugën çdo ndërhyrjeje të huaj në punët e Shqipërisë, ndërsa në veçanti i preu rrugën çdo kritike që i bëhej myslimanëve në vend si një fe që e pengonte bashkimin kombëtar dhe qytetërimin.

Rrugën e filluar në vitin 1923 komuniteti mysliman e vijoi me vendosmëri edhe në kongreset e tjera që ai zhvilloi. Në Kongresin e Dytë të korrikut të vitit 1925 u shqyrtuan çështje administrative, me të cilat u morën tri komisione: ai i shqyrtimit të statutit, komisioni për vendosjen e rregullores së brendshme dhe për vendosjen e rregullores së medresesë<sup>38</sup>.

Sukseset e arritura deri në këtë kohë nga komuniteti mysliman ndihmuan në përmirësimin e imazhit të vendit në arenën ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë, qëndrimi i tyre ndaj kodit civil bëri një përshtypje të mirë brenda dhe jashtë vendit. Në këtë mënyrë ata dhanë një mesazh maturie dhe emancipimi për të gjithë popullin dhe veçanërisht për komunitetet e tjera fetare. Ky fakt u evidentua edhe në parlamentin shqiptar gjatë seancave të diskutimit për kodin civil. Në fjalën e mbajtur në parlament, Salih Vuçiterni evidentoi rolin pozitiv që luajtën myslimanët, të cilët nuk bënë asnjë ankim. Ai i përgëzoi ata për faktin se, ashtu siç kishin bërë sakrificë për sigurimin e pavarësisë kombëtare, bënë

<sup>36</sup> Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e mbretit Zogu I*, Tiranë, 1996, f.54.

<sup>37</sup> Q. Xhelili, *vep. e përm.*, f.230.

<sup>38</sup> “Zani i Naltë”, qershor-korrik, f.485.

sakrifica edhe për votimin e këtij kodi<sup>39</sup>. Këtë qëndrim pozitiv të myslimanëve e vinte re edhe “Gazeta e Korçës” e datës 17 shkurt 1929, e cila shkruante se të pranuarit e kodit civil në vend të sherihatit nga kleri mysliman pa ndonjë ankim, ishte një punë e madhe. Në artikujt e saj për këtë çështje ajo vërente se ky komunitet prekej më tepër nga kodi civil se ai katolik (ata e kundërshtuan këtë kod, pasi ai njihte të drejtën për divorc) dhe përsëri ai nuk ankohej, por pranonte me bindje ligjet e shtetit.

Myslimanët qëndrimin e tyre ndaj ligjit e shfaqën në revistën e tyre “Zani i Naltë”. Në artikullin e shkruar në këtë revistë të dhjetorit 1928, krerët e këtij komuniteti deklarorin se anëtarët e xhemijetit nuk ishin kundërshtarë të kodit civil, pasi e kuptonin së çështja e të bërit të ligjës dhe aplikimit të saj nuk i përkiste fesë por kombit. Ky kod nuk sillte asnjë pengim në ndërgjegjen e frymëzuar nga feja islame dhe mund të aplikohet me ndërgjegje nga çdo mysliman. Një deklaratë e tillë për një vend ku 70% e popullsisë ishte myslimane, ishte tepër pozitive për emancipimin e popullit të thjeshtë, por edhe rriste prestigjin e këtij komuniteti në vend, duke fituar respektin e besimeve të tjera fetare.

Myslimanët e vazhduan të vendosur rrugën drejt reformimit edhe në Kongresin e Tretë të tyre të mbajtur më 6 korrik 1929 në Tiranë. Kongresi u hap me fjalën e shpirtit të islamit shqiptar Vehbi Dibrës, i cili përmendi edhe një herë nevojën e reformimit dhe të organizimit të trupit mysliman nën egjidhjen e Mbretit, shpëtimtarit të kombit<sup>40</sup>. Agjah Libohova, i dërguari i qeverisë dhe Ferid Vokopola shpjeguan më pas reformat që duhej të kryeshin dhe rëndësinë e tyre. Ky kongres ndryshe nga dy të parët u mor edhe me sigurimin e mirëmbajtjes e objekteve fetare, ndërsa një komision i veçantë u mor me hartimin e raportit vlerësues për të ardhurat e vakëfeve<sup>41</sup>. Kongresi shqyrtoi probleme të njohura tashmë në këtë komunitet, por që nuk kishin marrë ende zgjidhje.

Një prej tyre ishte miratimi i një ligji për kufizimin e mbajtjes së veshjeve fetare nga popullsia myslimane. Këtë çështje Turqia e kishte zgjidhur kohë më parë, madje ajo kishte kufizuar veshjen fetare jashtë objekteve të kultit edhe në radhët e klerikëve. Shembullin e saj kërkuan ta përqafojnë edhe klerikët shqiptarë. Pjesë e diskutimeve u bënë medresetë dhe organizimi i tyre. U vendos mbyllja e medreseve ekzistuese dhe

<sup>39</sup> “Fletorja zyrtare”, 17 prill 1928.

<sup>40</sup> “Demokratia”, 13 korrik 1929, f.2.

<sup>41</sup> “Zani i Naltë”, shkurt 1930, nr.3, f.921.

hapja e një medreseje qendrore bashkëkohore dhe kombëtare, si dhe hapja e një internati me 100 nxënës. Përveç zvogëlimit të numrit të medreseve u vendos kufizimi i numrit të xhamive në 2-3 për çdo qytet në bazë të numrit të popullsisë<sup>42</sup>.

Suksesi i vërtetë i Kongresit ishte miratimi i statutit, në të cilin ligjërohej gjuha shqipe si gjuhë e lutjeve në të gjitha hytbet. Ndërsa për të administruar të ardhurat e vakëfeve u ngrit një komision i përbërë prej Teki Selenicës, Rexhep Matit, Ferid Vokopolës dhe Fiqri Rusit<sup>43</sup>. Në përfundim, Kongresi zgjodhi kryetarin e ri të komunitetit, pasi Vehbi Dibra doli në pension. Si kryemyfti i komunitetit mysliman u zgjodh Behxhet Shapati, një njeri me dije të plota në teologji dhe kulturë shekullore njohës i italishtes përveç arabishtes<sup>44</sup>. Drejtor i përgjithshëm i vakëfeve u zgjodh Xhemal Naibi, ndërsa drejtor i medresesë u zgjodh Ismet Dibra. Këshilli i lartë i sherihatit përbëhej nga Hafiz Xhaferi, myftiu i Korçës, Muharrem Mullahu, myftiu i Tiranës, H. Tahir, myftiu i Shkodrës dhe Halit Peshkëpi, myftiu i Gjirokastrës<sup>45</sup>.

Kështu myslimanët u bënë një element i rëndësishëm i shoqërisë shqiptare të kohës, prandaj me të drejtë Vehbi Dibra e quante një moment historik mbajtjen e këtij kongresi, i cili u bë faktor i forcimit të vëllazërisë midis myslimanëve dhe kristianëve.

Një rol të rëndësishëm në arritjen e këtyre sukseseve pati edhe revista “Zani i Naltë”, e cila e filloi veprimtarinë e vet qysh në vitin 1923, pas mbylljes së Kongresit të Parë Mysliman. Revista kishte tone të spikatura patriotike dhe radhitej pa rezerva për një reformë të islamit shqiptar në drejtim modernizues<sup>46</sup>. Kjo revistë u bë përçuese e rrymave të moderuara të islamit në vend duke kontribuar në shpejtimin e reformave. Ajo evidentoi qysh në fillimet e veta problemet që preknin trupin mysliman. Një prej tyre ishte përkthimi i librave të shenjta. Kjo reviste i bënte thirrje të vazhdueshme klerikëve, por edhe intelektualëve, që t’i përvisheshin punës në përkthim për të ndihmuar popullin mysliman.

Një tjetër çështje për të cilën shkroi në faqet saj kjo revistë, ishte problemi i arsimimit të popullit. Ajo propozonte shkollimin e djemve nga i gjithë vendi me edukatë fetare dhe kombëtare. Duke dërguar në medrese

<sup>42</sup> “Demokratia”, 13 korrik 1929, f.2.

<sup>43</sup> “Gazeta e Korçës”, 7 korrik 1929, f.3.

<sup>44</sup> “Demokratia”, 3 gusht 1929, f.1.

<sup>45</sup> Po aty.

<sup>46</sup> R.M. dela Roka, *vep. e përm.*, f.30.

një djalë për çdo 50 familje shkollohej një pjesë e mirë e popullit. Pas përfundimit të shkollimit ata caktoheshin imamë në fshatin e tyre kundrejt një page, ku gjysma paguhej prej shtetit dhe gjysma tjetër prej popullit të fshatit<sup>47</sup>.

Vend të rëndësishëm në faqet e kësaj reviste zinin diskutimet në lidhje me reformimin fetar të islamit. Interesante ishin polemikat e zhvilluara midis Salih Vuçiternit dhe Ali Hafëz Krajës. Salih Vuçiterni argumentonte se myslimanët e Shqipërisë, në qoftë se dëshironin të jetonin, duhej të hiqnin dorë nga mentalitetet e vjetra që kishin dhe të largoheshin sa më shpejt nga fraza arabe vexhedna aba-ena, të nisnin punët me llërë të përveshura duke çmuar përvojat e kohës sa më parë që të jetonin dhe të përparonin<sup>48</sup>. Në vazhdim të opinioneve të tij, ai e shikonte si një hap të domosdoshëm mbylljen e xhamive të tepërta nëpër qytete dhe vendosjen në krye të tyre të klerikëve të përgatitur.

Në një artikull tjetër drejtuar myslimanëve ai shkruante se ishte turp të rrinin në këtë gjumë, kur po lulëzonte bota mbarë. Një qeveri e rregullt e udhëhiqte popullin drejt një përparimi e qytetërimi në qoftë se përpiqej edhe vetë populli që të merrte atë udhë<sup>49</sup>.

Duke njohur rolin që kishte komuniteti mysliman i bëhej thirrje atij që të bëhej pjesë e përparimit, i cili ishte i domosdoshëm për bashkimin e vërtetë të elementëve të popullit shqiptar. Mjeti i realizimit të bashkimit ishte dhe mbetej liberalizimi i fesë myslimane. Me anë të këtyre artikujve ai vinte para përgjegjësisë myslimanët me argumente të bazuara tek ndjenja kombëtare, por shpesh herë sillte edhe shembullin e Turqisë moderne. Shqiptarët ashtu siç kishin pranuar në mënyrë pozitive rrëzimin e Kalifatit nga Ataturku duhet të ndiqnin rrugën reformuese të tij për evropianizimin e Shqipërisë.

Përballë këtyre pikëpamjeve reformatore qëndronin disa zëra konservatorë në radhët e klerit të lartë shqiptar. Ata mendonin se reformat fetare nuk ishin të domosdoshme dhe se gjendja ekzistuese nuk mbarte probleme për vendin dhe komunitetin mysliman. Ky qëndrim lidhej me edukimin fetar që merrnin këta klerikë.

Në botën islamike kishte disa shkolla fetare, të cilat dallonin nga njëra-tjetra për interpretimin që i bënin rregullave të Kuranit ose për

<sup>47</sup> “Zani i Naltë”, maj 1930, nr.3, f.462.

<sup>48</sup> Po aty, 1927-1928, nr.2-3, f.469.

<sup>49</sup> Po aty, 1928, nr.4, f.502.

pikëpamjet e tyre kundrejt çështjeve më të rëndësishme të botës islame, si dhe raportin e tyre me shtetin dhe shoqërinë. Ndër to dalloheshin dy shkolla, ajo e Lahorës në Indi me pikëpamje liberale, dhe ajo El-Azhar në Kajro të Egjiptit me pikëpamje konservatore<sup>50</sup>. Elementë konservatorë u shfaqën edhe në vendin tonë. Ndër ta ishte myftiu i Shkodrës, i cili i kritikonte novatorët në komunitetin mysliman në Shqipëri<sup>51</sup>. Ali Hafiz Kraja ndodhej në mes të këtyre dy pikëpamjeve duke ruajtur një qëndrim të moderuar. Në artikujt e tij ai vlerëonte shkrimet e shenjta të besimit islam, duke u shprehur se nuk është turp të respektohej Kurani dhe sherihati që urdhëronin bashkim dhe vëllazërim. Ai kritikonte nismat e Salih Vuçiternit për mbylljen e medreseve, të cilat ishin vendi ku përgatiteshin drejtuesit e ardhshëm të komunitetit mysliman.

Një klerik tjetër, më pak i moderuar, replikon me Salih Vuçiternin duke u shprehur se me reformë nuk nënkuptohej shkelja e urdhërimeve të shenjta të Kuranit dhe krijimi i diçkaje të re, pasi reformat ndodheshin tek vetë ai<sup>52</sup>. Hafiz Ali Kraja në artikujt e tij shpjegonte se për sigurimin e normave morale dhe ruajtjen e harmonisë në shoqërinë njerëzore nuk kishte mjet tjetër më të fuqishëm veç fesë. Feja ndihmonte individët të merrnin përgjegjësi të detyrës, në këtë kuptim e ndihmonte kombin. Ajo nuk ishte kundër evolucionit kombëtar, por ndofta ishte shpirti i këtij evolucionit<sup>53</sup>.

Në këtë kohë edhe një figurë e rëndësishme e kohës si Mehdi Frashëri dha mendimin e vet mbi reformimin e komunitetit mysliman. Ai përdori elementë të shkencave sociologjike në shpjegimin e problemeve të ndryshme që kishin të bënin me evoluimin e fesë. Në artikujt e tij në “Gazetën e Re” ai i tërhoqi vëmendjen islamit shqiptar për reformim. Sipas tij reforma duhej të ligjëronte monogaminë, t’i jepte lirinë e plotë gruas myslimane dhe të kujdesej për përgatitjen e duhur të klerit të tij. Ai ndalej në këtë pikë të fundit, të cilës i jepte një rëndësi të veçantë.

Për zgjidhjen e këtij problemi Mehdi Frashëri propozonte që kleri të përgatitej në shkollat perëndimore ku të pajisej me një kulturë të përgjithshme, por mbi të gjitha të edukohej me një frymë perëndimore. Më pas studentët më të përgatitur të mësonin gjuhën arabe në Universitetin e Gjuhëve Orientale në degën e arabishtes. Mehdi Frashëri

<sup>50</sup> E. Jacques, *vep. e përm.*, f.440.

<sup>51</sup> R.M. dela Roka, *vep e përm.*, f.30.

<sup>52</sup> “Zani i Naltë”, dhjetor 1927, nr.2, f.421.

<sup>53</sup> Ali Hafiz Kraja, *A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar?*, Shkodër, 1934, f.67.

propozonte hapjen e një medreseje qendrore ku mësimi i arabishtes të bëhej me metodën moderne të quajtur Bërlitz<sup>54</sup>. Këtyre studentëve të edukuar në shkollat perëndimore, klerikë të ardhshëm, u takonte më vonë të bënin një interpretim më të moderuar të shkrimeve të shenjta. Autori shprehej se derisa të krijoheshin kjo kategori klerikësh, duhej pritur, ndërsa ata ekzistuesit duhej të kufizoheshin në praktikat e fesë, por anëtarët e këshillave myslimane duhej të ishin njerëz të ditur dhe profesionistë.

Këto kritika të vazhdueshme e shqetësonin komunitetin mysliman, i cili përpiqej të ruante prestigjin e tij. Ai e këshillonte klerin e vet që të bënte kujdes në veprimtarinë e tij pasi ishte nën vëzhgimin e opinionit publik. Në revistën e vet ky komunitet ndër të tjera shkruante se hoxha ishte bërë objekt i kritikave të ashpra që shpesh e pengonin të kryente misionin e tij. Kritikët jo gjithmonë ishin objektivë. Hoxhallarët që të dilnin fitimtarë duhej të hartonin me kompetencë një program të caktuar. Ata e vlerësonin si të domosdoshme lidhjen e bashkëpunimin e hoxhallarëve me intelektualët, pa marrë parasysh pozitën e tyre<sup>55</sup>.

Në këtë artikull i bëhej thirrje intelektualëve të merrnin pjesë në reformimin e myslimanëve duke krijuar një institut të lartë shtetëror ku të rrihnin mendimet mbi reformën fetare në bazë të normave të islamit dhe t'u jepnin përgjigje të mjaftueshme atyre që mendonin se islamizma pengonte qytetërimin. Ata duhej të hiqnin dorë nga kritika të paargumentuara ose nga indiferenca, dhe të jepnin mendimet e tyre për reformimin. Në këtë mënyrë ata i shërbenin vërtet komunitetit mysliman dhe kombit. Kështu shfaqej fytyra e vërtetë e islamit, e cila e përkrahte qytetërimin dhe hidheshin poshtë akuzat që i bëheshin myslimanëve. Në këto debate komuniteti mysliman shfaqti një pjekuri mendimi, pasi u tregua i hapur ndaj kritikave, duke i parë me objektivitet ato.

Kërkesat për reformim të islamit nuk reshtën. Ato vinin nga të gjitha anët duke vënë para përgjegjësisë këtë komunitet, me të njëjtin lajtmotiv: Presim reforma.

Në radhët e këtyre kërkesave rreshtoheshin ato të liberalëve dhe rinisë, të cilët ishin të pakënaqur me gjendjen ekzistuese.

Kritika vinin edhe nga eksponentë të komuniteteve të tjera fetare. Kështu, Namik Delvina në artikullin e tij të publikuar në gazetën "Ora e Maleve" shkruante se myslimanët ndryshe nga komunitetet e tjera fetare

<sup>54</sup> "Gazeta e Korçës", 8 mars 1928, f.4.

<sup>55</sup> "Zani i Naltë", gusht-shtator, nr.9-10, f.1125.

nuk e zhvillonin pikëpamjen kombëtare në fenë e tyre. Autori, madje i quante ata gati indiferentë në zhvillimin kombëtar duke i akuzuar për përdorimin e gjuhës arabe në predikimin fetar dhe jo të gjuhës shqipe. Ai i propozonte atyre krijimin e një kori në gjuhën amtare në xhami<sup>56</sup>.

Komuniteti mysliman këtyre akuzave u përgjigjej me argumentet se xhamia i përmbahej programit kombëtar, megjithëse kishte një program që përfshinte gjithë besimtarët e islamit jo vetëm ata të një kombi. Ndërsa përsa i takonte predikimit, ai kishte kohë që bëhej në gjuhën shqipe në hytbat e së premtës, në festat kombëtare dhe ceremonitë e veçanta të komunitetit. Ndërsa gjuha arabe përdorej vetëm në interpretimin e Kuranit madje edhe si gjuhë e korrespondencës përdorej gjuha shqipe<sup>57</sup>.

Këto argumente tregonin se komuniteti mysliman kishte bërë hapa të mëdhenj drejt reformimit gjatë këtyre viteve. Ai e kishte përdorur gjuhën shqipe qysh në vitin 1923 pas Kongresit të Parë të tij. Në ceremoninë e parë me predikim në gjuhën shqipe morën pjesë përfaqësues të qeverisë e të parlamentit.

Në fillim lutja e myftiut u bë në arabisht, por më pas gjuha shqipe kumboi në mënyrë triumfale në sallë<sup>58</sup>. Ky ishte hapi i parë drejt reformimit, sukcesi i parë që parapriu të tjerët nën vulën e bashkimit kombëtar. Për këtë arsye nuk do të ishte e drejtë t'i mohonim ato. Heqja dorë nga gjuha e Muhametit në leximin e Kuranit përbënte një ngjarje pothuaj revolucionare në universin kulturor islamik<sup>59</sup>.

Një sukses i padiskutueshëm i këtij komuniteti ishte reforma për heqjen e perçes nga gratë myslimane dhe liberalizimi i pozicionit të saj në shoqëri. Kjo iniciativë i kishte fillesat qysh në vitet 1923-1924. Në një artikull të “Orës së Maleve” i kërkohej qeverisë që të nxirrte një ligj për heqjen e perçes nga gratë myslimane<sup>60</sup>. Kjo çështje u diskutua përsëri në vitin 1929, kur në krye të kësaj lëvizjeje u vu kleri i lartë mysliman Behxhet Shapati dhe klerikë të tjerë të lartë, të cilët dhanë të parët shembullin e emancipimit duke i nxjerrë gratë e tyre pa perçe.

Për këtë çështje shkruante edhe “Demokratia”, e cila i lutej z. Shapati të interesohej personalisht për këtë plagë të shoqërisë. Ajo shpjegonte se këtë dispozitë populli ynë e kishte huazuar nga Turqia, por

<sup>56</sup> Po aty, 1932, nr.6, f.157.

<sup>57</sup> Po aty, f.211.

<sup>58</sup> Po aty, 1923, nr.1, f.10.

<sup>59</sup> R.M. dela Roka, *vep. e për.*, f.28.

<sup>60</sup> “Zani i Naltë”, gusht 1924, nr.11, f.348.

kur kjo e fundit e kishte hedhur poshtë këtë zakon të vjetruar përse duhej të mbahej në vendin tonë<sup>61</sup>?

Ishte e qartë se emancipimi i gruas në vend tregonte shkallën e emancipimit të kombit tonë dhe na vinte në një nivel me popujt e qytetëruar. Më vonë një shoqëri jashtëshkollore, e themeluar në Elbasan nga Xhafer Piraku, i bëri thirrje intelektualëve që të jepnin ndihmesën e tyre në këtë çështje kaq të rëndësishme shoqërore<sup>62</sup>. Zbulimin e fytyrës së gruas e propozuan myftinjtë e Gjirokastrës, Halit Jusufi (Peshkëpia) e të Korçës, Hafëz Xhaferri. Hapin përfundimtar në këtë drejtim e ndërmori Behxhet Shapati, i cili në një mbledhje të Këshillit të Lartë të komunitetit mysliman dorëzoi një raport i cili shpjegonte se heqja e perçes nuk binte ndesh me Kuranin. Pasi ky raport u shqyrtua, Këshilli mori vendimin për zbulimin e fytyrës dhe duarve të gruas myslimane. Ky vendim u nënshkrua dhe u pranua nga të gjithë anëtarët e këshillit: Salih Myftija, Halit Jusufi, Ferid Vokopola, Halid Rroji, Mazhar Këlliçi, Muharrem Mullahi, Fejzi Alizoti, Abdurrahman Dibra, Ahmet Hastopalli, Ismet Heseveja, Behxhet Shapati, Salih Vuçiterni, Hafëz Xhaferri, Shazivar Allturi, Ekrem Vlora. Më pas anëtarët e Këshillit të Lartë mysliman vunë në dijeni për këtë raport edhe qeverinë mbretërore në vullnetin e së cilës varej mënyra e realizimit të këtij vendimi<sup>63</sup>.

Ky ishte një kontribut tjetër i komunitetit mysliman në emancipimin e jetës shoqërore të vendit në emër të reformimit të tij të brendshëm, por në radhë të parë në emër të bashkimit kombëtar.

### *S u m m a r y*

#### ASPECTS OF THE ACTIVITY OF THE MUSLIM COMMUNITY DURING THE MONARCHY PERIOD IN THE CONTEMPORARY PRESS

The historical developments through which our country has gone through have created a complex religious mosaic. However in this mosaic has been evident the sense a tolerance which has been obvious in the difficult moments our country has gone through in its history. The religion became an integral part

<sup>61</sup> "Demokratia", 24 gusht 1929, f.2.

<sup>62</sup> "Besa", 21 nëntor, 1935, f.3.

<sup>63</sup> "Zani i Naltë", 1937, nr.3, f.73.

of the national platform that aimed the preservation of the national existence and the declaration of the independence of the country.

The religious tolerance was another element that became part of the difficult process of consolidation of the Albanian state. A balancing policy was pursued by the Congress of Lushnja that had in its High Council representatives from the four religious groups in country. The same policy was followed by Ahmet Zogu by appointing at the top of the communities reformatory elements and above all good patriots. The government through the laws of the state placed in lawful context aspects of the social life and family of its citizens. During the long trajectory of reformation it was not only the government and the intellectuals that were faced with the oldness but also the high clergy of religious communities with special emphasis of the Muslim one. Essential part of this movement was the Muslim community that gave an important help in the social emancipation of the country through the self-shaping. In the same manner this community had given a precious contribution for the National Movement and the achievement of the victory of the independence of the country where important figures such as Vehbi Dibra (Agolli), Hafiz Maliq, Haxhi Vildani had been distinguished. After the initiation of this process of inner reformation of the religious groups it was also initiated the work for the compilation of a law that would define the status of the religious communities in relation with the government. In effort to fulfil this aim it was approved the decree-law for the religious communities of 1923. These congresses opened the road for the inner reformation of the religious communities by defining the regulations and the statutes.

The most important decisions of the first Congress were: the clergy could be only Albanian, the preaching language to be used needed to be in Albanian, the reformation of the status of the Muslim woman by asking for the law that would have banned the use of the headscarf, and the training of the clergy for the translation of the holy writings in the Albania language.

In the second congress were analysed administrative issues. The stand toward the civil code helped in the improvement of the image of the country in the international community.

The real success of the third congress was the approval of the statute in which was defined the use of the Albanian language as the language of the prayers in all the hytbe. So in this context Vehbi Dibra very rightly considered this as an important historical moment the holding of this congress what in fact became a factor in the strengthening of the brotherhood between the Muslims and the Christians.